



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT
DREKTORIA E PËRGJITHSHME

Nr 1217 Prot.

Tiranë, më 07.11.2014

RREGULLORE

**PËR NDALIMIN E PIRJETËSË DUHANIT NË AMBIENTET E AUTORITETIT
KOMBËTAR TË USHQIMIT**

Në zbatim të ligjit Nr.9636, datë 06.11.2006 “Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit” i ndryshuar me ligjin nr.49/2013 datë 14.02.2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në nr.9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” dhe Ligj Nr 76/2014 “Për disa Shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.9636, datë 06.11.2006 “Për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”, si dhe VKM Nr 1081 datë 21.10.2009 “Për Organizimin e dhe funksionimin e AKU” e ndryshuar, miratohet sa më poshtë:

Neni 1

Ndalohet konsumi i duhanit në të gjitha ambientet e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit si:

- a) Zyrat;
- b) Korridoret;
- c) Tualetet;
- d) Automjetet;
- e) Mjediset e përbashkëta të qarku limit brenda godinës.

Neni 2

Në të gjithë institucionin, vendosen shenja paralajmëruese të madhësisë 40 cm² me mbishkrimin “NDALOHET DUHANI” në vendet ku mund të lexohen nga largësia 5 m.

Neni 3

Në faqen zyrtare të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit do të publikohet në vend të dukshëm, një mesazh informues për ndikimin e duhanpirjes që ka ai në shëndet dhe rreziqet nga produktet e duhanit.

Neni 4

Për punonjësit të cilët e konsumojnë duhanin, caktohet hapësira jashtë objektit e cila do të përdoret ekskluzivisht si vendi ku do të konsumohet duhan.

Neni 5

Për të gjithë punonjësit, të cilët do të identifikohen duke konsumuar duhan në vendet e përcaktuara sipas nenit 1, do të ndërmerren masa në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr. 9636, date 06.1.2006 "Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit" i ndryshuar, ku janë të përcaktuara sanksionet me gjobë dhe do të ndërmerren masa disiplinore për personat që janë në shkelje të kësaj rregullore.

Neni 6

Me qëllim zbatimin rigoroz të ligjit antiduhan dhe kësaj rregullore, detyrohen të gjithë punonjësit që identifikojnë persona të cilët konsumojnë duhanin brenda institucionit të AKU-së, të lajmërojnë personin përgjegjës në mënyrë që të merren masat e nevojshme.

Neni 7


Personat përgjegjës për zbatimin e kësaj rregullore janë Drejtori i Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme, si dhe Drejtorët e Drejtorive Rajonale të AKU-së. Personi përgjegjës është i detyruar në vendosjen e shenjave të dukshme, të cilat demostrojnë se pirja e duhanit në këto mjedise ndalohet, si dhe të mundësojë heqjen dhe moslejimin e tavllave të duhanit në këto mjedise.

Neni 8

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHM

Afrim BAKAJ



Miratoi: Lavdi Kajmaku
Konfirmoi: Vjosa Kalemaj
Konceptoi: Lorina Kollaku